

Kadare – Krishtlindjet në New York

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

Ç'lidhje të ketë viti i shkrimit të poezisë me atmosferën e saj? Cila të jetë lidhja e kësaj atmosfere me titullin?

Cila është atmosfera e strofës së parë?

Me cilat fjalë jepet vogëlsia, pamundësia e njeriut për të kuptuar gjithçka ndodh?

Në gjithë pjesën e parë ndihet një shqetësim. Cili është realisht shqetësimi, në ç'lloj shqetësimi e shndërron Kadareja dhe si përcillet?

Përfundimisht në pjesën e parë shqetësimi lidhet me pritjen dhe moskuptimin e vonesës. Çfarë pritet?

-shënime-

Ku duket që gjithçka që mund të shërbejë si urë lidhëse me qiellin nuk funksionon?

E ka fajin koha e keqe që është prishur lidhja e vjetër mes qiellit dhe njeriut (siç duan të thonë njerëzit)?

Cili është ai që pritet në pjesën e dytë? Gjeni detajet që na japin të dhëna për të. Cila është e çuditshmja në këtë pritje?

Cili është krimi që përmendet në strofën e fundit të pjesës së parë?

Me kë bën antitezë pritja e bujshme në strofën e dytë të pjesës së dytë?

A ka faj njeriu që ka dymijë vjet që enigmës së hershme se kujt i përket Krishti nuk po i jep dot përgjigje?

-shënime-

Analizoni fjalët: shestim i thyer, ndërgjegjja e vvarë, fluturimi që vdiq, pakt, besë e thyer, ëndrra tragjike për qiellsi.

Pse përmenden diamantet në pjesën e tretë?

Të kini parasysh që dritën e ditës e thithin diamantet dhe dita është e ngrysur, madje nxin.

Cili është fati i paracaktuar i njeriut? Pse ka këtë fat, kush ja dha?

Pse plagët e Krishtit paralelizohen me drita semaforësh?

**A e kish fajin stuhia që njeriu ka humbur lidhjen me qiellin? Ku duket kjo?
Ku qëndron faji përfundimisht?**

Ese

A mund ta shohim këtë si poezi fetare? Jepni mendimin tuaj në formën e një eseje.